



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SIGURIME”

(Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK)

Kodi: L2-IV-23

TIRANË, 2025

Programi orientues për provimet përfundimtare për Kualifikimin Profesional “**Sigurime**”, **Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe të 13-të, që i përket këtij niveli sipas Skeletkurrikulit përkatës.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Gjatë punës me këtë program kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimin përfundimtar, është e rëndësishme që herë pas here instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të përdorë teknikat e ndryshme të komunikimit me klientët, furnitorët e shërbimeve të sigurimeve dhe eprorët Të mbajë korrespondencën zyrtare në shoqëritë e sigurimeve	Detyra 1: Komunikimi në shoqërinë e sigurimeve	5
2.	Të kryejë shitjet për produkte jete dhe jo-jete. Të kryejë blerjen e produkteve për mbulimin e dëmeve të të siguruarve.	Detyra 2: Veprime të shitjes dhe blerjes në sigurime	15
4.	Të kryejë procedurat për mbulimin e dëmit dhe dëmshpërblimin e tij.	Detyra 3: Veprime të trajtimit të dëmeve	10
5.	Të kryejë llogaritjen e çmimit (të primit) për produktet e sigurimit	Detyra 4: Llogaritje të çmimit (të primit) në sigurime	30
6.	Të kryejë llogaritjen e veprimeve që lidhen me punën dhe personelin si dhe kontabilizimet për veprimet e kryera në agjencinë e sigurimeve	Detyra 5: Kontabilizime të thjeshta në sigurime	40
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”, në mjedise të simuluar në zyrën e firmës ushtrimore.
- Koha për realizimin e **të gjitha detyrave** duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
Në vlerësimin e kompetencave profesionale rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Rekomandohet të përgatiten paraprakisht pyetje, të cilat mund të përdoren gjatë këtij bashkëbisedimi.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrave përkatëse. Vlerësimi të kryhet duke hartuar më parë një listë kontrolli, duke vendosur pikët në varësi të peshës (rëndësisë) për secilën kompetencë ose elementë të kompetencës profesionale.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj. Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme.

Detyra 1 - “Komunikimi në shoqërinë e sigurimeve”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e zyrave mësimore. Nxënësit në mënyrë individuale në varësi të situatës së dhënë do të përdorin teknikat e ndryshme të komunikimit me klientët, furnitorët e shërbimeve të sigurimeve, kolegët dhe eprorët për zgjidhjen e problemeve.

Të regjistrojë korrespondencën zyrtare në shoqëritë e sigurimeve për dokumentet në hyrje dhe dalje. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 2 – “Veprime të shitjes dhe blerjes në sigurime”

Kjo detyrë konsiston në hartimin e kërkesave për oferta, marrjen e ofertave dhe vlerësimin e tyre, dërgimin e konfirmimeve të ofertave, marrjen e faturave, kontrollin dhe pranimin e tyre si dhe urdhërshkrimin për likuidimin e detyrimit përkatës. Për realizimin e detyrës anëtarët e komisionit të provimit duhet të vënë në dispozicion të nxënësve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në formën e formularëve model, të cilët do të plotësohen më pas nga nxënësit. Atyre do t’u vihet në dosje dhe një aktmarrëveshje ri-sigurimi dhe disa të dhëna nëpërmjet të cilave do të bëjë plotësimin.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 3 – “Veprime të trajtimit të dëmeve”

Për realizimin e kësaj detyre nxënësit i vihen në dispozicion të dhëna dhe dokumente që kanë të bëjnë me aktin e vlerësimit për dëmin e ndodhur, faturën e shitjes si dhe urdhërshkrimin.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 4 - “Llogaritje të çmimit (të primit) në sigurime”

Kjo detyrë ka si objektiv përfundimtar llogaritjen e çmimit. Kjo llogaritje kryhet nga çdo nxënës për të paktën **një produkt sigurimi** (TPL, Kasko, sigurim jete etj.) që agjencia e sigurimit mund të ofrojë. Nxënësve u jepen të dhënat e nevojshme si : numri i saktë i mjeteve, individëve apo ndërtesave/aseteve, etj. që janë objekt sigurimi. Në bazë të të dhënave nxënësi duhet të ndjekë hapat për llogaritjen e çmimit (të primit), llogaritjen e primit të pastër, llogaritjen e primit neto, llogaritjen e primit kontraktual, llogaritjen e primit të faturuar dhe në fund plotësimin e kontratës së sigurimit.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Detyra 5 - “Kontabilizime të thjeshta në sigurime”

Kjo detyrë mund të realizohet duke simuluar një situatë në lidhje me veprimtarinë e një agjencie sigurimi. Nxënësit duhet t’i jepen të dhëna për të plotësuar listë pagesën dhe listën e kontributeve të sigurimeve shoqërore duke llogaritur paraprakisht pagën ditore për efekt raporti mjekësor, llogaritjen e pagës së ditëve me raport, llogaritjen e ditëve që paguhen nga sigurimet shoqërore, ndalesat, TAP dhe pagën neto. Në dokumentet e mësipërme nxënësi gjen të pasqyruara vlerat përkatëse dhe vijon me kontabilizimet e veprimeve të kryera në agjencinë e sigurimeve (të shitjes, blerjes, pagesave, arkëtimeve dhe veprimeve që lidhen me punën dhe personelin në agjencinë e sigurimit).

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Duke qenë se kjo detyrë përmban më shumë kompetenca duhet të ketë peshën më të madhe të pikëve.